

VENDIM
Nr. 627, datë 15.7.2015

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR REGJISTRIMIN E ENTIT MENAXHUES NË NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 9, të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është miratimi i kriterëve për regjistrimin e entit menaxhues në njësinë e qeverisjes vendore.

2. Në kuptim të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, “Ent menaxhues” është personi juridik ose fizik, i cili ka në kompetencë administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale të dhëna me qira e të bonusit të strehimit.

II. KRITERET PËR REGJISTRIMIN E ENTIT MENAXHUES

1. Personi juridik ose fizik i regjistruar në QKR paraqet pranë njësisë së qeverisjes vendore kërkesën me shkrim për regjistrim për ushtrimin e veprimtarisë për administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale e të bonusit të strehimit.

2. Mënyra e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale me qira përcaktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Banesat me qira administrohen në bazë të një kontrate me entet menaxhuese të cilat janë persona juridikë, publikë ose privatë, apo persona fizikë të regjistruar në njërin prej formave të përcaktuara sipas ligjit.

3. Kërkesa drejtuar njësisë së qeverisjes vendore nga enti menaxhues duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Njësinë e qeverisjes vendore së cilës i drejtohet;

Identifikimin e entit menaxhues, si person fizik apo juridik, objektin e veprimtarisë si dhe adresën e saktë të selisë;

b) Datën, nënshkrimin dhe vulën e personit fizik apo juridik.

4. Njësia e qeverisjes vendore regjistron entin menaxhues, nëse plotëson këto kriterë:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me status aktiv;

b) Në objektin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera, duhet të ketë administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale e të bonusit të strehimit;

c) Sipas rastit, personi fizik ose administratori dhe personi juridik apo ortakët e tij nuk rezultojnë të jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Enti menaxhues regjistrohet nga njësia e qeverisjes vendore pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në këtë vendim dhe pas paraqitjes së dokumentacionit të mëposhtëm:

a) Kërkesës për regjistrim në njësinë e qeverisjes vendore;

b) Ekstraktit të QKR-së, original ose kopje të njëzuar me originalin, të marrë jo më parë se 3 muaj nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrim;

c) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore, të lëshuar jo më parë se 3 muaj, nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrim.

III. PROCEDURA PËR PRANIMIN, REFUZIMIN OSE PLOTËSIMIN E TË METAVE TË KËRKESAVE TË PARA-QITURA PËR REGJISTRIM NË NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngre strukturën përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për regjistrim të enteve menaxhuese në njësinë e qeverisjes vendore.

2. Struktura përgjegjëse ndjek procedurën për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për regjistrim, së bashku me dokumentacionin shoqërues, të depozituar nga enti menaxhues.

3. Kërkesa, së bashku me dokumentacionin shoqërues për regjistrimin ose çregjistrimin e entit menaxhues, regjistrohet në një regjistër. Forma dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen nga njësia e qeverisjes vendore.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse të njësisë së qeverisjes vendore janë:

a) Pranon kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues;

b) Shqyrton dhe verifikon kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga enti menaxhues;

c) Njofton kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore për rastet kur enti menaxhues i përmbush ose jo kriteret për regjistrimin e tij.

5. Njësia e qeverisjes vendore, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, vendos:

a) pranimin e kërkesës;

b) refuzimin e kërkesës;

c) kthimin e dosjes për plotësim dokumentacioni brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.

Plotësimi i të metave në dokumentacion nga enti menaxhues bëhet brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga njësia e qeverisjes vendore. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të përcaktuar më sipër sjell refuzimin e kërkesës.

6. Kërkesa e paraqitur nga enti menaxhues nuk pranohet nga njësia e qeverisjes vendore, në rastet kur:

a) kërkesa është paraqitur nga një person jo i autorizuar;

b) nuk plotëson të dhënat e përgjithshme të parashikuara në këtë vendim;

c) nuk është shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar sipas këtij vendimi;

ç) nuk janë plotësuar të metat e kërkesës sipas të dhënave të kërkuara nga njësia e qeverisjes vendore, në përputhje me parashikimet e pikës 5, të kreut III, të këtij vendimi;

d) enti menaxhues ka hequr dorë nga kërkesa për regjistrim.

7. Njësia e qeverisjes vendore, brenda 8 ditëve nga data e marrjes së vendimit, njofton me shkrim entin menaxhues.

8. Njësia e qeverisjes vendore vendos në lidhje me çregjistrimin e entit menaxhues:

a) me kërkesë të këtij ent;

b) kur personi fizik ose përfaqësuesit apo ortakët e personit juridik dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) kur enti është në proces likuidimi ose falimentimi;

ç) kur enti humb statusin si person juridik ose fizik.

9. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama